

LIGJ

Nr.9650, datë 27.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8607, DATË 27.4.2000 “STATUSI I DËSHMORIT TË ATDHEUT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Brendshme”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në fund të paragrafit të parë, pas fjalëve “këshilli i qarkut” shtohen fjalët “apo prefekti”.
2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, për ushtrimin e përgjegjësive të caktuara në ligj, mbështetet nga një staf teknik. Këshilli i Ministrave përcakton organin e linjës, pranë të cilit funksionon ky staf. Përgjegjësi i stafit teknik ushtron

funksonet e sekretarit të Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Stafit teknik ka përgjegjësi që, brenda 45 ditëve nga afati i mbërritjes së propozimit, të verifikojë dokumentacionin, sipas nenit 3 të këtij ligji, të hartojë relacionin, projektaktin, si dhe projektin e rendit të ditës dhe t'ia përcjellë ato kryetarit. Kryetari i Komisionit, sipas dokumentacionit të dërguar nga stafi teknik, cakton rendin e ditës. Çdo propozim përfshihet në rendin e ditës dhe shqyrtohet në Komision brenda 3 muajve nga afati i dorëzimit të praktikës së plotë nga stafi teknik.

Kur kanë kaluar 3 muaj, por kërkesa nuk është shqyrtuar sipas këtij ligji, kërkuesi ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të vendosë detyrimin ndaj Kryetarit të Komisionit, për të përfshirë kërkesën menjëherë në mbledhjen më të parë të Komisionit. Gjykata, brenda 10 ditëve, shqyrton kërkesën dhe jep vendim për çështjen.

Stafi teknik ndjek zbatimin e vendimeve të Komisionit dhe njofton të interesuarin.”.

Neni 3

Fjalja e parë e nenit 5 zëvendësohet me paragrafët me këtë përmbajtje:

“Kërkesa, së bashku me dokumentet përkatëse, sipas nenit 3 të ligjit, i paraqitet për shqyrtim këshillit të qarkut ose prefektit, që ka juridiksion në territorin ku ka vendbanimin familja e dëshmorit. Këshilli i qarkut ose prefekti, brenda 6 muajve nga afati i regjistrimit, shqyrton kërkesën për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”.

Kur është plotësuar afati 6-mujor nga afati i regjistrimit dhe kërkesa nuk është shqyrtuar sipas ligjit, kërkuesi ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të vendosë detyrimin e institucionit për të trajtuar kërkesën menjëherë, sipas procedurës në fuqi. Gjykata, brenda 10 ditëve, shqyrton kërkesën dhe jep vendim për çështjen.”.

Neni 4

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Shpërblimi, sipas nenit 13 të ligjit, u jepet familjarëve. Në rrethin e familjarëve bëjnë pjesë bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut. Shpërblimi ndërpritet kur asnjëri nga familjarët nuk plotëson kushtet e përcaktuara më sipër. Shpërblimi familjar tërhiqet nga kryefamiljari i Dëshmorit të Atdheut ose, në rast mosmarrëveshjeje, kur është më shumë se një person, nga secili sipas pjesës që i përket.”.

Neni 5

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Në familjen e Dëshmorit të Atdheut, për efekt nderimi dhe mirënjohjeje, përfshihen bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat.”.

Neni 6

Dispozita kalimtare

Pas mbarimit të tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përfitues të shpërblimit financiar mbeten vetëm personat e përcaktuar në rrethin e familjarëve, sipas nenit 4 të këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e nenit 4 të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5154, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu